

Data 06.06.2024

## AKTI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË

### “ESG Construction” Sh.p.k

- **Z.Saxhid Gjorllaku**, i datëlindjes 15.12.1993, i lindur në Diber dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i indentifikua nga pasaporta me nr. **J31215008V**, me nr.telefoni 069 282 3941.

Të cilët mbështetur në Ligjin Nr.9901 dt. 14/04/2008, “Për shoqëritë Tregtare” dhe në Legjislacionin shqiptar në përgjithësi, kanë vendosur si më poshtë:

#### Emërtimi, Selia dhe afati i Shoqërisë

##### Neni 1

Të themelojë shoqërinë me përgjegjësi tëkufizuar, për të zhvilluar veprimtari private.

Shoqëria është person juridik Shqiptar, Veprimtaria e të cilës rregullohet nga kjo kontratë, Statuti i saj dhe Legjislacioni në fuqi.

##### Neni2

Shoqëria do të emërtohet “**ESG Construction**” Sh.p.k

##### Neni 3

Selia e Shoqërisë “**ESG Construction**” Sh.p.k do të jetë në Tiranë, Kamez Rruga “Skenderbeu”, lagjja nr. 2,pallati “Point Center”, kati i pare, numer pasurie 89/47

##### Neni 4

Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin e saj me afat të pakufizuar. Ky afat mund të zgjatet ose të shkurtohet me vendim asamblesë së ortakëve.

Shoqëria “**ESG Construction**” Sh.p.k gëzon statusin e personit juridik shqiptar nga moment i regjistrimit si e tillë në regjistrin e QKB-së.

##### Neni 5

Objekti i aktivitetit të shoqërisë “**ESG Construction**” Sh.p.k do të jetë:

Punime elektrike, tregtim me shumice e pakice te materialeve elektrike, import eksportin e tyre, prodhim dhe tregtim betoni dhe inerte, tregtim me shumice dhe me pakice, import-eksport te artikujve te ndryshem industrial,ushqimore, elektroshtepiake, konfeksione, kozmetike. Tregtim dhe shitje produktesh artizanati, kimike,tekstile,artikuj plastike. Tregtim produktesh te gatshme me shumice e pakice, etj. Ne fushen e ndertimit, te ndertimeve civile, industriale, turistike, bujqesore, mbi 2 kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to. Ne fushen e projektimit dhe zbatimin duke perfshire por pa u kufizuar I veprave urbane,civile, industriale, arkitekurore, rrugore dhe

hekurudhore, urave dhe veprave te artit, si dhe punime inxhinierike topografike dhe hidrologjike, inxhinierike te impianteve te prodhimit dhe transmetimit te energjise etj.

Ofrimin e rrjeteve dhe sherbimeve te komunikimeve elektronike. Permiresim dhe shfrytezim te pyjeve. Transportkombetar dhe nderkombetar per mallra te ndryshem dhe/ose udhetare per te trete dhe me qira. Transport i karburanteve. Sherbime pastrimi dhe mirembajtjeje te ambienteve te brendshme dhe te jashtme, industriale dhe civile, publike dhe private, reklamave e totemeve te ambienteve spitalore,qendrave shendetesore,qendrave tregtare, hoteleve, zyrave, universiteteve, marketeve, bankave, bar - restoranteve, porteve, aeroporteve,2 terminaleve, rruge etj. Tregtim (Shitje-Blerje),furnizim,importim me shumice e pakice te detergjenteve, produkteve, materialeve, pajisjeve, mjeteve,aksesoreve, makinerive te pastrimit. Sherbime dhe mirembajtje gjelberimi dhe te mjediseve te gjelberta.Transport, grumbullim dhe evadim te mbetjeve urbane,pastrim i hapësirave te qyteteve, fshatrave etj, dhe trajtimi e riciklimi i mbetjeve. Transport me mjete jashte norme. Riparimi dhe mirembajtja e pjeseve mekanike dhe te motorit,te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove. Riparimi dhe mirembajtja e karrocise, te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove. Riparimi dhe mirembajtja e impiantit elektrik, te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove. Riparimi dhe mirembajtja e gomave, te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove. Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkio. Mbledhja, depozitimi, shkaterrimi i mjeteve ose pjeseve te tyre te dala te perdorimit apo te braktisura. Prodhim,shfrytezim, perpunim, tregtim, transporti gurit gelqeror. Prodhime materiale ndertimi: prodhim materiale inerte, qeramike, tulla tjegulle, fajence, gres, prodhim elementesh te parafabikuara,betoni, beton-arme. Punimet e montimit dhe teknologjike,montimi dhe instalimi i impianteve termike te ventilimit dhe kondicionimit te ajrit etj. Prodhim pllakash betoni per trotuare dhe rruge. Prodhim bordura betoni per trotuare dhe rruge.

#### **Neni 6**

Shoqëria ushton aktivitetin e saj mbi bazë dege në qytete të tjera të vendit, të cilat do të hapen pasi të ketë filluar aktiviteti i shoqërisë.

#### **Neni 7**

Selia e shoqërisë mund të transferohet.

#### **Neni 8**

Kur shoqëria pushon veprimtarinë e saj, pasi shlyhen të gjitha detyrimet që ka, pjesën e mbetur të kapitalit dhe të të ardhurave i përfitojnë ortakët e saj.

Ortakët themelues përballojnë humbjet e shoqërisë deri në kufirin e vlerës së tij të derdhur në formimin e kapitalit themeltar. Kapitali baze mund të ritet nga fitimi në natyrë, ose kredi në lekë ose valutë qe merret në Bankat e Shtetit Shqiptarë. Kapitali Themeltar për vazhdimin e aktivitetit të shoqërisë është në shumën **7 000 000 Lekë** , që i takon ortakëve themelues.

Ortakët pas zbritjes së taksave do t'i ndahen si vijon:

- Fondi Rezervë
- Shpërblimi që i takon ortakëve themelues në masën 100%.

#### **Neni 9**

Shoqëria mund të hyjë në veprimtari të përbashkëta me shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja.

## Neni 10

Veprimtaria e Shoqërisë mund të ushtrohet duke krijuar filial ose përfaqësi brenda dhe jashtë vendit, në konformitet me Ligjin Shqiptar ose të huaj.

### **Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve Ortakët gëzojnë këto të drejta kryesore**

#### Neni 11

- Administrimin e veprimtarisë në përputhje me kontratën dhe statutin.
- Pjesëmarrjen në rezultatet e cdo forme dhe sasi të veprimtarisë së shoqërisë e parashikuar në kontratën dhe statutin e saj.
- Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga mbledhja e përgjithshme e Asamblesë dhe organet e tjera të shoqërisë.
- Të heqë dorë nga shoqëria, heqja dorë nga shoqëria nuk i liron ortakët nga detyrimet financiare të marra më parë ndaj shoqërisë.
- Të marrë pjesë në organet e shoqërisë që janë ose mund të krijohen nëpërmjet përfaqësuesit të tij ose vetë.
- Të emërojë dhe të shkarkojnë përfaqësuesit e saj, punonjësit, ekspertin kontabël dhe likuidatorët.

### **Ortakët kanë këto detyrime kryesore:**

- Të depozitojnë kuotën e tyre dhe kuotën suplementare në përputhje me kontratën dhe statutin.
- Të marrë pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara nga vetë ata.
- Ti japë Shoqërisë të dhënat e domosdoshme për përpunimin e cdo objekti të vecantë lidhur me veprimtarinë e saj.
- Të kryejë detyrat për realizimin e objektivave dhe të funksioneve të shoqërisë.
- Ka detyrimin nëse heqin dorë nga shoqëria ti njoftojnë vendimin e tij asamblesë 6 muaj përpara dhe duke ceduar të drejtën e zgjedhjes sipas nenit.
- Ti japi shoqërisë informatat e nevojshme që kanë të bëjnë me ecurinë e veprimtarisë së saj.
- Të kryejë shërbimet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe realizimin e funksioneve të saj.

## Administrimi

**Organi vendimor i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.**

#### Neni 12

### **ADMINISTRATORI**

Veprimtaria operative e shoqërisë drejtohet nga Administratori i saj i Përgjithshëm. Në “**ESG Construction**” Sh.p.k, Administrator i Shoqërisë do të jetë Z. **Saxhid Gjorllaku** e cili në të njëjtën kohë ka edhe funksionin e përfaqësimit të shoqërisë me të tretët në të gjithë veprimtarinë e tij. Me miratimin e ortakëve mund të emërohen administrator dhe përfaqësues të shoqërisë “**ESG Construction**” Sh.p.k



Administratori emërohet për një kohëzgjatje prej pesë vjetësh finaciare me përjashtim të rasteve të dorheqjes ose shkarkimit të parakohshëm. Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet me interes të shoqërisë dhe në emër të saj nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë me përjashtim të atyre kompetencave që ligji nuk i njeh. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë apo të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të statusit apo për faj të tij gjatë administrimit të shoqërisë.

#### **Mbyllja e Shoqërisë:**

##### **Neni 13**

Veprimtaria e shoqërisë pushon me propozimin e bërë nga ortakët, kur gjatë dy vjetëve nuk rezulton rentable si dhe të gjitha rastet që parashikohen në dokumentet e krijimit të shoqërisë (kontrata). Shoqëria shpërndahet në formë riorganizimi ose likuidimi.

#### **Kur shoqëria likuidohet:**

##### **Neni 14**

Asambleja e ortakutëve emëron likuidatorin, dhe shoqëria i jep fund veprimtarisë së saj në castin e miratimit të këtij bilanci të likuidimit. Komisioni I Likuidimit përbëhet nganjë ose tre anetarë. Pasuritë që janë venë në dispozicion të shoqërisë me të drejtë shfytëzimi, shiten në vartësi të shkallës së konsumit të tyre. Mjetet finaciare të fituara si rezultat i veprimtarisë së shoqërisë e të filialeve të saj dhe fondeve finaciare ndahen ndërmjet ortakëve në përputhje në përpjestim me kuotat e vëna, pasi të jenë bërë pagesat për kreditorët.

##### **Neni 15**

Kur pushon Veprimtaria e një filiali, për efekte të riorganizimit të tij, afatet e pushimit caktohen nga Asambleja e Përgjithsme e ortakut.

Likuidimi i filialeve bëhet njësoj si për shoqërinë. Mjetet finaciare vihen në dispozicion të shoqërisë pasi tu jenë bërë pagesat likuiditorëve.

Dispozita të hollsishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj.

#### **ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË**

**Z.SAXHID GJORLLAKU**

SAXHID

GJORLLAKU

